



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.145, datë 15.06.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Rifat Kojku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.
2. Zoti Rifat Kojku do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, nga data 19.06.2022 - 18.09.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Rifat Kojku do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Rifat Kojku, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 15.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

Anëtar
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Doda

ANËTAR
Mirela Bogdani